



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
GJKATA KUSHTETUESE  
УСТАВНИ СУД  
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 17 gusht 2011  
Nr. ref.: RK128/11

## **AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI**

në

**Rastin Nr. KI57-09**

**Parashtrues**

**Agron Vula**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të komunës së Gjakovës për moszbatimin e Vendimit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës, të 25 shkurtit 2008**

### **GJKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

E përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar  
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar  
Robert Carolan, gjyqtar  
Altay Suroy, gjyqtar  
Almiro Rodrigues, gjyqtar  
Snezhana Botusharova, gjyqtare  
Ivan Čukalović, gjyqtar  
Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe  
Iliriana Islami, gjyqtare

#### **Parashtruesi i kërkesës**

1. Parashtrues është z. Agron Vula, me vendbanim në Gjakovë, që fillimisht nuk ishte i përfaqësuar, por tani përfaqësohet nga z. Taki Bokshi, avokat nga Gjakova.

## **Vendimi i kontestuar**

2. Vendimi i komunës së Gjakovës (në tekstin e mëtejme: komuna) për moszbatimin e Vendimit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës, të 25 shkurtit 2008, që të paditurës i ishte dorëzuar më 17 mars 2008.

## **Objekti i çështjes**

3. Parashtruesi e parashtrroi kërkesën në Sekretariatën e Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Gjykata) më 21 tetor 2009, në të cilën pohonte që Vendimi i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës, i 25 shkurtit 2008, nuk ishte zbatuar nga punëdhënësi i parashtruesit, komuna. Vendimi i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës e urdhëronte komunën që ta shqyrtonte rastin dhe ta nxirrte një vendim meritore.

## **Procedura në Gjykatën Kushtetuese**

4. Parashtruesi e parashtrroi kërkesën në Sekretariatën e Gjykatës Kushtetuese më 21 tetor 2009. Parashtruesi atëherë nuk ishte i përfaqësuar. Ai tani përfaqësohet nga Teki Bokshi, avokat nga Gjakova. Parashtruesi ankohet që Vendimi i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës, i 25 shkurtit 2008, nuk ishte zbatuar dhe që i ishin shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 49.1 të Kushtetutës së Kosovës, nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore, dhe nenin 23 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut, në lidhje me nenin 21.1.1 të Kushtetutës së Kosovës.
5. Kryetari i Gjykatës Kushtetuese e caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova Gjyqtare raportuese dhe e caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët Ivan Čukalović (kryesues), Enver Hasani dhe Iliriana Islami.
6. Nëpërmjet letrës së 21 janarit 2010, drejtuar përfaqësuesit ligjor të parashtruesit, Gjykata Kushtetuese kërkoi sqarim për disa dokumente të dorëzuara me kërkesën fillestare.
7. Nëpërmjet letrës pasuese, të 1 shtatorit 2010, Gjykata ia dërgoi kërkesën komunës së Gjakovës, me të cilën kërkonte që komuna ta ofronte përgjigjen e vet lidhur me këtë kërkesë së bashku me arsyetimin dhe informacionet dhe dokumentet e nevojshme mbështetëse.
8. Komuna u përgjigj më 30 shtator 2010 dhe theksoi se rasti ishte ende në procedurë gjyqësore dhe se, si rrjedhojë, rasti në Gjykatën Kushtetuese ishte i papranueshëm.
9. Një kopje e përgjigjes së komunës iu dërgua përfaqësuesit ligjor të parashtruesit më 4 tetor 2010 dhe ai iu përgjigj Gjykatës më 26 tetor 2010, duke theksuar, ndër të tjera, se një Vendim ishte nxjerrë nga Gjykata e Qarkut në Pejë, C. nr. 121/09, i 7 prillit 2009. Përgjigja nuk e trajtonte në mënyrë të plotë çështjen e procedurës aktuale, që u shkaktua si pasojë e suspendimit të parashtruesit, që ende nuk është zgjidhur nga Gjykata e Qarkut në Pejë.
10. Gjykata e shqyrtoi këtë çështje më 14 dhjetor 2010.

## **Përmbledhja e fakteve**

11. Parashtruesi ishte punësuar, në bazë të një kontrate të përkohshme të punësimit, si shef i Njësisë së Parandalimit dhe Mbrojtjes nga Zjarri në komunën e Gjakovës. Ai ishte suspenduar përkohësisht nga detyrat prej 20 gushtit 2003 “deri në përfundimin

e procedurës për verifikimin përgjegjësive apo papërgjegjësive disiplinore". Atij duhej t'i paguhej gjysma e të ardhurave mujore gjatë suspendimit të përkohshëm.

12. Ankesa e tij kundër këtij suspendimi ishte dëgjuar së fundi nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës më 28 shkurt 2008. Vendimi i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës e urdhëronte komunën e Gjakovës ta shqyrtonte rastin dhe ta miratonte një vendim meritor. Vendimi nuk u zbatua. Në vend të kësaj, komuna pohon që ekziston një procedurë e pazgjidhur gjyqësore lidhur me këtë çështje dhe ia siguroi Gjykatës një aktgjykim të Gjykatës Komunale në Gjakovë sipas të cilit parashtruesit i ishte kompensuar rroga e papaguar. Komuna pohon se u ankua kundër këtij aktgjykimi në Gjykatën e Qarkut në Pejë, e cila ende nuk ka vendosur në lidhje me këtë rast.
13. Gjykata Kushtetuese ka siguruar kopjen e ankesës së komunës drejtuar Gjykatës së Qarkut në Pejë; kjo procedurë është ende e pazgjidhur.

### **Vlerësimi i pranueshmërisë**

14. Për të gjykuar për kërkesën e parashtruesit, Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë dhe të specifikuar më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.
15. Neni 113.7 i Kushtetutës thotë:

*"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike dhe të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

16. Gjykata dëshiron të theksojë përsëri se arsyetimi për rregullin e shterimit të mjeteve juridike është që t'ua lejojë autoriteteve në fjalë, duke përfshirë gjykatat, mundësinë për ta parandaluar ose korrigjuar shkeljen e supozuar të Kushtetutës, në të cilën parashtruesi thirrej para atyre instancave. Ky rregull bazohet në supozimin se rendi juridik i Kosovës do të sigurojë mjet efikas juridik për shkeljen e të drejtave kushtetuese (shih, *mutatis mutandis*, GJEDNJ, Selmouni kundër Francës, Nr. 25803/94, Vendimi i 28 korrikut 1999). Megjithatë, nuk është e nevojshme që të drejtat kushtetuese të cekën në mënyrë eksplicite në procedurën në fjalë. Nëse çështja ishte ngritur në mënyrë implicite ose në substancë, rregulli i shterimit të mjeteve juridike është plotësuar (shih, *mutatis mutandis*, GJEDNJ, Azinas kundër Qipros, Nr. 56679/00, Vendimi i 28 prillit 2004).
17. Gjykata e zbatoi të njëjtin arsyetim kur nxori Aktvendimin për Papranueshmëri në rastin Universiteti AAB-RIINVEST L.L.C., Prishtinë kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës, Rastin KI 41/09, i 27 janarit 2010, dhe në Aktvendimin për Papranueshmëri në rastin Mimoza Kusari-Lila kundër Komisionit Qendror Zgjedhor, Rasti Nr. KI 73/09, i 23 marsit 2010.
18. Pasi procedura përkatëse lidhur çështjen e zbatimit të Vendimit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës ende nuk ka përfunduar dhe gjersa kjo procedurë ende nuk ka përfunduar, është e parakohshme që Gjykata Kushtetuese të merret me këtë rast. Prandaj, rezulton që parashtruesi nuk i ka shteruar të gjitha mjetet juridike që i ka në dispozicion sipas ligjit në fuqi, siç kërkohet me nenin 113.7 të Kushtetutës.

## PËR KËTO ARSYE

Në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit dhe nenin 54 (b) të Rregullores së punës, Gjykata Kushtetuese, në seancën e mbajtur më 14 dhjetor 2010, njëzëri

### VENDOS

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese;
- III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Snezhana Botusharova

Gjyqtare raportuese

Prof. Dr. Enver Hasani

Kryetar i Gjykatës Kushtetuese